



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.12.2014, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Hungarisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Blendi Klosi, Pirro Lutaj, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Nard Ndoka dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Xhemal Qefalia, Spartak Braho, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Mark Frroku, Keltis Kruja, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Ramadan Çaço – përfaqësues i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
Danja Sinanaj – përfaqësuese e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit me kuorumi u formua. Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e dy projektligjeve, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Hungarisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar” dhe projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike”. Për të dyja këto projektligje, jemi Komision për dhënie mendimi.

Fillojmë me projektligjin e parë në rendin e ditës “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Hungarisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar” . Kush do ta prezantojë projektin? Po z. Çaço, një përmbledhje pasi anëtarët e kanë përpara projektligjin:

Ramadan Çaço - Kjo marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e rregullave të përgjithshme të sigurisë që do të zbatohen për çdo shkëmbim informacioni të klasifikuar ndërmjet palës shqiptare dhe asaj hungareze ose ndërmjet institucioneve të tyre publike ose private, të cilat i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të tyre kombëtare.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit. Ka pyetje? Nuk ka. Kush është dakord me projektligjin në parim? Dakord. Miratohet projektligji në parim. Neni 1. Dakord. Neni 2. Dakord. Jemi dakord në tërësi me projektligjin? Ka kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet projektligji edhe në tërësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.12.2014, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Blendi Klosi, Pirro Lutaj, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Nard Ndoka dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Xhemal Qefalia, Spartak Braho, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Mark Frroku, Keltis Kruja, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Milbana Treska – drejtore e Drejtorisë së Drejtimit të Borxhit Publik në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me projektligjin tjetër në rendin e ditës, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike”. Nga Ministria e Financave ka ardhur znj. Treska, Drejtore e Borxhit Publik në këtë ministri.

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka. Jemi dakord me projektligjin në parim ? Dakord. Miratohet. Neni 1. Dakord. Neni 2. Dakord. Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Dakord. Ka kundër? Abstenim? Nuk ka. Miratohet projektligji edhe në tërësi. Ju faleminderit. E mbyllim këtu mbledhjen për sot. Ju faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA